



Qeveri efektive për rritje më të fuqishme

- Rritja qëndron e pandërprerë dhe rikuperimi ciklik është afër përfundimit jashtë Federatës së Shteteve të Pavarura (CIS), ekonomitë e CIS-së po dalin gradualisht nga rënia apo recesioni. Megjithatë, tendenca e rritjes qëndron shumë më e ulët sesa përpara krizës.
- Politikat makroekonomike duhet të rrenjosin një balancë midis mbështetjes së rritjes afatshkurtër dhe rindërtimit të rregullatorëve fiskalë. Ruajtja e rritjes së fuqishme kërkon reforma të mëtejshme strukturale, të fokusuara në fuqizimin e institucioneve dhe në rritjen e efikasitetit qeveritar.
- Përmirësimi i menaxhimit të investimit publik dhe administrimi i taksave mund të ndihmojë në çlirimin e 2-4 përqind të burimeve shtesë, të cilat mund të përdoren për të rritur investimin publik ose për të reduktuar deficitet fiskale.

Vrulli i rritjes qëndron i fuqishëm


Rikuperimi ciklik është afër përfundimit në shumicën e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (EQLJ-L). Jashtë Federatës së Shteteve të Bashkuara (CIS), rritja vazhdoi me një vrull të mirë, e mbështetur nga politika të favorshme, dhe e drejtuar nga konsumimi pluskues. Pavarësisht nga inflacioni ende i ulët, rikuperimi ciklik paraqitet që të jetë afër përfundimit në këtë zonë të rajonit, me përqindje të papunësisë që po bie në nivelet e para-krizës, me rroga që po rriten vazhdimisht, dhe me hovin në rritje të rikuperimit të kredisë. Në CIS, kursi i tkurrjes ka qenë duke u zbutur në Rusi, ndërsa çmimet e naftës po u afrohen çmimeve të ulëta, ndërsa pjesa tjetër e CIS-së po del gradualisht nga rënia, në kurriz të kërkesës së jashtme të përmirësuar. Për rajonin, si pjesë e tërë, rritja e GDP-së është projektuar që të arrijë 1.3 përqind¹ në 2016 dhe 2.1 përqind në 2017, duke reflektuar në shkallë të gjerë panoramën e përmirësuar të CIS-së.

Parashikimi Real i rritjes së GDP (në përqindje)

	CESEE ¹	Baltics ^{1,2}	Central and Eastern Europe (CEE) ^{1,3}	Southeastern Europe EU (SEE-EU) ^{1,4}	Southeastern Europe non-EU (SEE-non-EU)	Other CIS ^{1,6}	Russia	Turkey
2015	-0.2	1.8	3.7	3.3	2.2	-4.2	-3.7	4.0
2016	1.3	2.3	2.8	4.1	2.9	-0.7	-0.8	3.3
2017	2.1	3.0	3.0	3.3	3.2	1.1	1.1	3.0

CESEE: Parashikimi i Rritjes së GDP-së (në përqindje)

1



Burimi: Databaza e Panoramës Ekonomike Botërore të FMN-së.

1/ Mesatarja e ponderuar nga GDP e vlerësuar me barazinë e fuqisë së blerjes. 2/Estonia, Latvia, Lituania; 3/ Rep. Çeke, Hungaria, Polonia, Republika Sllovaqe, dhe Sllovenia; 4/Bullgaria, Kroacia, dhe Rumania; 5/ Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e ish-Jugosllavisë, Mali i Zi dhe Serbia; 6/Bjellorusia, Moldova, dhe Ukraina.

Rreziqet qëndrojnë të anuara nga ana negative. Disa rreziqe, të tilla si ritmi i normalizimit të politikës monetare në ekonomi të avancuara dhe kriza e refugjatëve në Evropë, duket më pak e spikatur sesa gjashtë muaj më parë. Rreziqe të tjera, të tilla si ato të shoqëruara me mosmarrëveshjet politike në rritje, me pasigurinë në dukje të brendshme, dhe pasigurinë e politikës, janë bërë më të theksuara. Pavarësisht nga impakti modest deri tani, efektet afatgjata të Brexit-it janë të paqarta, sidomos me pasiguritë që kanë të bëjnë me marrëveshje të reja ekonomike midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian.

Politikat makroekonomike duhet të arrijnë një balancë midis mbështetjes së rritjes afatshkurtër dhe rindërtimit të rregullatorëve fiskalë. Gjatë periudhës afatshkurtër, politika monetare duhet të qëndrojë e favorshme, duke pasur parasysh inflacionin e ulët që pritet të jetë. Politika fiskale pritet që në përgjithësi të jetë neutrale ose e zmadhueshme, me shumicën e vendeve që kanë deficite strukturale fiskale. Në vendet kur rritja e qëndrueshme ka vazhduar për një numër vitesh dhe kurset e papunësisë janë kthyer te shifrat e niveleve të parakrizës, atëherë këto kohë relativisht të mira duhet të përdoren për të rindërtuar rregullatorë fiskalë sa më shumë që të jetë e mundur me masa që favorizojnë rritjen.

Megjithatë, rritja e fuqishme afatmesme kërkon reforma të mëtejshme strukturore

Tendenca e rritjes është shumë poshtë niveleve të parakrizës. Duke marrë parasysh investimin e ulët dhe të dhënat demografike të pafavorshme, vendet e CESEE-së mund të mos jenë në gjendje që ta ruajnë rritjen e tanishme të fuqishme pa një rritje të konsiderueshme të produktivitetit, ose duke ballafaquar një shpërndarje të rinovuar të çekuilibrove të jashtme. Ngritja e investimit dhe produktivitetit mund të kërkojë reforma të mëtejshme strukturore të fokusuar në fuqizimin e institucioneve dhe në rritjen e efikasitetit qeveritar. Kjo e fundit është fokusi i raportit të Çështjeve Ekonomike Rajonale të Vjeshtës 2016.


Një qeveri më efektive mund të ndihmojë rritjen

Hapësirat e Fondeve Kapitale Publike Për Person

Nevoja për të ngritur rritjen potenciale dhe për të rindërtuar rregullatorë fiskalë

vendos një prim në përmirësimin e menaxhimit të investimit publik dhe në administrimin e taksave në CESEE. Duke ditur që shumica e vendeve në rajon kanë një hapësirë në fondet kapitale publike dhe infrastrukturë, relativisht me Evropën e avancuar (shih Figurën), ekziston një sferë e fuqishme për investim publik, i cila – nëse kryhet me efikasitet – do ta fuqizojë rritjen potenciale në rajon. Në të njëjtën kohë, shumë vende të CESEE-së ende po ballafaqohen me deficite të mëdha fiskale. Në këtë kontekst, përmirësimi i institucioneve të menaxhimit të investimit publik dhe administrata e taksave mund të ndihmojnë për të çliruar burime të shtesë që mund të përdoren për të fuqizuar investimin publik ose për të reduktuar deficitet e larta fiskale.

(Përqindja e fondeve kapitale EU-15 për person, 2015)



Burimi: Investimi FMN-së dhe Dataset i fondeve kapitale (ICSD).
Shënim: CEE = Evropa Qendrore & Lindore; CIS = Federata e Shteteve të Pavarura; SEE-XEU = Vendet Evropiane Juglindore jashtë Bashkimit Evropian.


Bërja e investimit publik më efikas, do të kërkonte përmirësimin në menaxhimin e investimit publik.

Përmirësimet e mëtejshme duhet të fokusohen në alokimin dhe implementimin e sistemeve dhe procedurave, ku vendi për përmirësim është tepër i madh në shumicën e vendeve në rajon (shih Figurën). Vendet CESEE që nuk përfshihen në BE, gjithashtu do të përfitonin nga rritja e transparencës së implementimit, duke siguruar disponueshmëri të menjëhershme të fondeve, si dhe përmirësimin e rregullatorëve të kompanisë, dhe menaxhimin e partnerizimeve publike-private (PPPs). Në vendet CESEE të BE-së, institucionet e menaxhimit të investimeve publike shoqërohen me përvetësimin më të lartë të fondeve të BE-së.

CESEE vs. Vendeve të ngjashme: Fuqizimi i Institucioneve të Menaxhimit Publik

(pikët 0 deri 10, 10 = më e mira)

— EU, excl. CESEE — CESEE-EU — CESEE-non-EU



Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së.

Fuqi e administratës së taksave në zonat thelbësore


(10 = më efikase)

[Raporti i plotë gjendet](#)

[Artikulli i lajmeve të FMN gjendet](#)

Përmirësimet në administratën e taksave duhet të synojnë në reduktimin e hapësirave të nënshtrimit ndaj taksave.

Edhe pse shumë vende në rajon kanë elementë thelbësorë të administratës moderne të taksave (Shih Figurën), hapësirat e nënshtrimit ndaj taksave janë ende të mëdha. Përpjekjet e reformës duhet të fokusohen në sjelljen e marrëveshjeve institucionale në përputhje me praktikën më të mira (në vendet ku mbledhja e taksave nuk është e bashkuar në një institucion të vetëm, ose ku mungon një strukturë funksionale), në përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit (IT), në fuqizimin e përqaftjes së menaxhimit të rrezikut në nënshtrim ndaj taksave dhe në përmirësimin e përmbushjes operative (sidomos në vendet ku borxhi i taksave është i lartë).



Burimet: OECD; dhe llogaritjet e stafit të FMN-së.

Rritja e efikasitetit të investimit publik dhe administrimit të taksave mund të sjellin përfitime tepër të mëdha.

Duke reduktuar hapësirat (e parashikuar relativisht me standardet e matjes të nivelit të të ardhurave), vendet e CESEE mund të nxjerrin midis 2 dhe 4 përqind të GDP në kursime fiskale gjatë një periudhe afatmesme, që mund të përdoret ose për investim publik, ose për konsolidim fiskal. Duke përdorur vlerësime të përafërta standarde për koeficiente investimi publike (shih Panoramën Ekonomike Botërore të Tetorit 2014), sugjerohet që rritja e nivelit të GDP-së nga një investim i tillë shtesë mund të jetë 2-4 përqind gjatë periudhës afatmesme. Gjithashtu ka edhe përfitime më të gjëra kur ekzistojnë institucione më të mira publike, duke përfshirë edhe aktivitete më të pakta të paligjshme.